



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:265303

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05444445

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, në çështjen juridike të përmbarimit sipas propozimit për përmbarim të kreditores S.H., nga Gjakova, të cilën e përfaqëson Ylli Bokshi avokat në Gjakovë, kundër debitores së përmbarimit Komunës së Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për përmbarimin e dokumentit të ekzekutueshëm – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.1889/21, të datës 27.10.2022, i plotfuqishëm me datë 11.11.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 22.11.2022, për kompensimin e ushqimit gjatë punës, në shumë të përgjithshme prej 400.00 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, me datë 13 mars 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.URDHËROHET, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, 2021:265303 të datës 11.02.2023, për lejimin e përmbarimit të dokumentit të ekzekutueshëm - aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1889/2021, të datës 27.10.2022, i plotfuqishëm me datë 11.11.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 22.11.2022, për kompensimin e ushqimit gjatw punws, dhe atë - kreditores S.H., nga Komuna e Gjakovës, ti paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 400.00 euro, dhe shpenzimet të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumë prej 430.00 euro, respektivisht të gjitha detyrimet në shumë të përgjithshme prej 830.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitores së përmbarimit, Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit,

t'i barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores, Ylli Bokshi avokat në Gjakovë në xhirollogarinë bankare, "Avokatura Bokshi" SH.P.K. me numërnë Bankën TEB sh.a.

II. OBLIGOHET, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën t'a njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditores së përmbarimit, me aktvendimin 2021:265303, të datës 11.02.2023, ka lejuar përmbarimin ndaj debitores Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit. Ndaj këtij aktvendimi, debitorja ka ushtruar prapësim me datë 30.01.2023, ndërsa i autorizuari i kreditores me datë 01.02.2023 ka paraqitur përgjigje në prapsim. Duke vendosur lidhur me prapësimin e debitores, gjykata me aktvendim 2021:265303, të datës 16.10.2023 ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e lartcekur.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përmbarim, ka cekur mjetin e përmbarimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla dhe se pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, t'ia paguaj kreditores S.H., nga Komuna e Gjakovës, ti paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 400.00 euro, dhe shpenzimet të procedurës kontestimore dhe përmbarimore në shumë prej 430.00 euro, respektivisht të gjitha detyrimet në shumë të përgjithshme prej 830.00 euro, përmes bartjes së tyre në xhirollogarinë gjegjëse bankare dhe atë për këtë arsye:

Me shikim në shkresat e lëndës, 2021:265303, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbarimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.1889/21, të datës 27.10.2022, i plotfuqishëm me datë 11.11.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 22.11.2022, për shkak të detyrimit në të holla, si në rastin konkret me debitimin e mjeteve financiare përmes xhirollogarisë bankare, sipas nenit 152 të LPP-së, duke u bazuar në dokumentin e lartë cekur të përmbarimit, se debitorja, Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, është e obliguar që kreditores së përmbarimit, ti paguaj shumat e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lartë kjo gjykatë, vendosi që të urdhëroj Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2021:265303
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05444445

Prandaj, gjykata duke u bazuar në nenit 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
2021:265303, më 13 mars 2024

GJ Y Q T A R,
Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.